



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:209833

Datë: 24.02.2025

Numri i dokumentit: 06889297

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1442/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Valbonë Fejza me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Merita Mazreku, në çështjen penale kundër të akuzuarit N.G. për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.247/24 të datës 10.07.2024, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 24.02.2025 në prezencë të prokurorit së shtetit nga Prokuroria Themelore në Prishtinë Paulin Pashku dhe të akuzuarit të njëjtën ditë, në prezencë të palëve mori, publikisht shpalli dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N.G., nga babai B. dhe nëna Nj., mbiemri i vajzërisë së nënës L., i lindur me datënë Prishtinë, rr:” Sh.I.”, Kompleksi “...”, Hyrja ..., nr. ..., i pa martuar, montier i reklamave, i gjendjes ekonomike mesatare, i identifikuar përmes letërnjoftimit me nr. ..., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 15.12.2023, rreth orës 18:30, te “...”, në rrugën "...", në Prishtinë, pa autorizim ka poseduar substancë narkotike në atë mënyrë që zyrtarët policor e kishin ndaluar të pandehurin N. G., ku nga njësitë policore është kontrolluar vetura e të pandehurit e tipit Audi, dhe se gjatë kontrollit të njëjtit kishin gjetur substanca narkotike të llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme 0.22 gram,

-me këtë ka kryer veprë penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge” nga neni 269 par.2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe neneve 38, 39, 40, 42, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) e :

G J Y K O N

I. Të akuzuarit N.G., i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej 300.00 € (treqind) euro, të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata do ta zëvendësoj me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 euro të gjobës.

III. Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), ndërsa në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.

III. Urdhërohet konfiskimi i përhershëm i Substancës narkotike të llojit Kanabis-Marihuanë, që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë të përgjithshme prej 0.22 gram dhe e njëjta duhet të shkatërrohet nga Policia e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me datë 26.07.2024 pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.347/24 kundër të akuzuarit N.G. për shkak të veprës penale

Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KPRK-së.

Kjo gjykatë me datë 24.02.2025 ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën prezantuan prokurori i shtetit Paulin Pashku nga Prokuroria Themelore në Prishtinë si dhe i akuzuari N. G..

Prokurori i shtetit para leximit të aktakuzës, prokurori i shtetit bën ndryshimin e cilësimit juridik nga neni 269 par.1 në par.2 të të njëjtit nen, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar, i akuzuari N. G. deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale.

Gjyqtarja e vetme gjykuese vërteton se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklaroi: Pajtohem me pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Gjykata pas pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 242 par.2 të KPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 242 par.6 të KPRK-së, ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit prokurori i shtetit deklaroi “ I propozoj gjykatës që në raport me të pandehurin të merr parasysh disa rrethana lehtësues siç janë pranimi i fajësisë në të gjitha fazat e procedurës, fakti se i pandehuri për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, faktin se sasia e narkotikëve e gjetur tek i pandehuri është e vogël, faktin se i pandehuri nuk ka përdorë më narkotikë për një kohë të gjatë, gjendjen e tij shëndetësore i cili merr dy terapi për çështje që nuk kanë të bëjnë me përdorim të narkotikëve, gjykatës i propozoj që ndaj të njëjtit ti shqiptoj një dënim sa më të butë me të cilin përmbushen qëllimet nga neni 38 i KPRK-së”.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit i akuzuari deklaroi: " Për herë të parë jam para gjykatës, më herët nuk kam pasur asnjë rast, jam penduar shumë, nuk jam më konsumues i narkotikëve."

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge" nga neni 269 par.2 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, për çka edhe u shpall fajtor dhe iu shqiptua dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata kur vendosi të shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në dispozitat 38, 39, 40, 43, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074) dhe atë duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese të çështjes.

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me gjobë ose me burgim deri në 1 vit, e në këtë rast gjykata ndaj të akuzuarit vendosi që ti shqiptoj dënim me gjobë në lartësi prej 300 euro, i cili dënim do të paguhet nga i akuzuari në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund të paguaj gjobën, do ti zëvendësohet me burgim, ku për çdo 20 euro gjobë do të llogaritet një ditë burgim.

Duke i analizuar faktet e çështjes, gjykata erdhi në përfundim se në lidhje me të pandehurin për rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që, si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari edhe në procedurën paraprake e madje edhe në fillim të shqyrtimit fillestar ka bërë pranimin e fajësisë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu ka shfaqur pendimin e tij për veprën e kryer dhe se tashmë nuk është konsumues i substancave narkotike, nga evidenca penale e gjykatës konkretisht nga ekstrakti mbi dënimet penale të datës 21.02.2025 rezulton se i njëjti asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar, po ashtu gjykata si rrethanë lehtësuese mori gjendjen e tij shëndetësore jo të mirë duke qenë përdorues I dy terapive, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti.

Kur i shqiptoj dënimin me gjobë të akuzuarit, gjykata është bazuar në nenin 43 të KPRK-së dhe mori parasysh faktin se për këtë veprë penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1 një (vit), mirëpo meqenëse gjykata vendosi ndaj të akuzuarit shqiptimin e dënimit me gjobë, vlerësoi se gjoba duhet të jetë e këtij niveli siç është përcaktuar në këtë aktgjykim, sepse përmes gjobës të akuzuarit i bëhet me dije se ka kryer një veprë të kundërligjshme dhe se në të ardhmen duhet të ketë kujdes që të sillet në përputhje me rregullat shoqërore sepse përdorimi i substancave narkotike nuk është i lejuar as për përdorim personal. Në këtë kontekst gjykata erdhi në përfundim se lartësia e dënimit me gjobë prej 300€ (treqind euro) është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandalojë nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi mbi mundësin e zëvendësimit të dënimit me gjobë, në dënim me burgim është marrë në kuptim të nenit 43 pika 3 të KPRK-së.

Gjykata kur ka vendosur për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike të llojit Kanabis-Marihuanë, që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë të përgjithshme prej 0.22 gram të sekuestruar nga këtu i akuzuari, është bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, si dhe nenit 269 par. 3 të KPRK-së, pasi që ka vërtetuar se i akuzuari nuk posedonte leje, e as autorizim për posedimin e narkotikëve, e për më tepër substanca narkotike e lartcekur bën pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit është marrë në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjore nga neni 364 dhe 369 të KPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal

P.nr.1442/24, me datë 24.02.2025

Zyrtare Ligjore
Merita Mazreku

Gjyqtare e vetme gjykuese
Valbonë Fejza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.